

Botues: Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)

Hulumtimi është realizuar nga ekipi i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore

Autore: Luljeta Vuniqi

Realizimi teknik, disenji dhe shtypi: Drin Kryeziu

© 2014 Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

www.kgscenter.net

Përmbajtja

AKRONIMET	3
FALËNDERIMET	4
HYRJE	5
SI VOTOJNË GRATË NË KOSOVË?	6
ZGJEDHJA E PARË:	7
ZGJEDHJA E DYTË:	7
ZGJEDHJA E TRETË:	7
INFORMIMI	7
SITUATA PERSONALE	8
QËNDRIMET PËR ROLIN E GRUAS	8
SISTEMI ZGJEDHOR	9
REKOMANDIMET	9
REZULTATET E HULUMTIMIT	11
PASQYRA FAMILJARE E RESPONDENTEVE	11
INFORMIMI	12
NJOHURITË PËR BARTËSIT E INSTITUCIONEVE	13
RAPORTET NDËRINSTITUCIONALE DHE LLOGARIDHËNIA	13
QËNDRIMET MBI ROLIN E GRUAS NË FAMILJE DHE SHOQËRI	16
ROLI I GRUAS NË SHOQËRI	18
QËNDRIMET E GRAVE MBI ROLIN E SHTETIT NË EKONOMI DHE SHOQËRI	19
QËNDRIMET MBI ROLIN E GRUAS NË POLITIKË	21
MËNYRA E ZGJEDHJA E PRESIDENTIT/ES	24
ZGJEDHJET E FUNDIT PËR PUSHTETIN LOKAL	25
PRIORITETET E GRAVE	26
PREFERENCAT POLITIKE TË GRAVE	28
ARSYET	29
LISTAT E MBYLLURA VS. LISTAT E HAPURA	32
KUOTA GJINORE	33
VOTIMI FAMILJAR	34
REALIZIMI I HULUMTIMIT	35
MOSTRA	35
INSTRUMENTI I HULUMTIMIT	35
HULUMTIMI NË TERREN DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE	36
EKIPI	36

AKRONIMET

QKSGJ Qendra Kosovare për Studime Gjinore

KtK Kvinna till Kvinna

TMK Trupat Mbrojtse të Kosovës

FSK Forca e Sigurisë së Kosovës

EULEX Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

KKZ Këshillat Komunale Zgjedhore

KVV Këshillat e Vendvotimeve

PDK Partia Demokratike e Kosovës

LDK Lidhja Demokratike e Kosovës

LVV Lëvizja Vetëvendosje

AAK Aleanca për Ardhmërin e Kosovës

AKR Aleanca Kosova e Re

Falënderimet

Hulumtimi “Si votojnë gratë në Kosovë?” është një nismë e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore. Në emër të QKSGJ-së, fillimisht do të doja të shpreh falënderimin dhe mirënjohjen ndaj Kvinna Till Kvinna që e ka bërë të mundshëm këtë hulumtim.

QKSGJ i falënderon të gjithë intervistuesit për përkushtimin e tyre dhe gatishmërinë për bashkëpunim, si dhe pjesëmarrësit e grupeve punuese, të cilët e kanë pasuruar këtë studim me informacione dhe rekomandime.

Falënderime të veçanta për mbështetjen të vazhdueshme gjatë zbatimit të projektit janë edhe për anëtarët e Stafit të QKSGJ: Sibel Halimi, Luljeta Demolli, Merita Fona dhe Driton Parduzi.

Luljeta Vuniqi,

Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra Kosovare për Studime Gjinore

HYRJE

Barazia gjinore është e drejtë themelore njerëzore, një vlerë e përbashkët e shoqërive demokratike, dhe kusht i domosdoshëm për Kosovën në përpjekjet e saj për zhvillim të mëtutjeshëm të demokracisë, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe të grave në jetën politike dhe publike.

Raporti “Si votojnë gratë në Kosovë II” – analizon situatën dhe trendët e qëndrimeve, prioritetëve, botëkuptimeve të grave në Kosovë mbi politikën, politikanët, relacionet dhe rolet gjinore, si dhe politikatat publike të cilat promovojnë dhe fuqizojnë pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave në vendimmarrje.

Hulumtimi ka për qëllim të rrisë vetëdijen e publikut dhe institucioneve për situatën aktuale mbi pozitën e grave në shoqërinë kosovare si dhe të dhënat dhe rekomandimet nga ky raport të shërbejnë politikëbërësve, politikanëve, hulumtuesve, mediave, dhe institucioneve si bazë e njohurive për veprime konkrete të cilat do të përmirësonin pozitën dhe rolin e saj në familje dhe shoqëri. Të dhënat e hulumtimit tregojnë se është arritur një shkallë e progresit edhe përkundër përpjekjeve për të rritur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, gratë janë ende të nën-përfaqësuar në të gjitha sferat e pushtetit.

Kjo mbetet një sfidë e madhe për zhvillimin e demokracisë sonë. Meqë përfshirja dhe përfaqësimi i barabartë i grave në politikë dhe vendimmarrje vazhdon të jetë proces i ngadaltë, veprime strategjike nga të gjithë akterët është shumë i nevojshëm për të përmirësuar situatën aktuale.

Nga ana tjetër, ne besojmë se ky raport do të jetë edhe një kontribut i radhës i QKSGJ-së në pasqyrimin sa më të saktë të kontekstit tonë social e politik, duke sjell në pah qëndrimet dhe vlerësimet e grave dhe vajzave për një sërë çështjesh të shtjelluara në këtë raport. Në veçanti konsiderojmë se mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave të krahasueshme për pikëpamjet, prioritetet dhe pritjet e grave nga politika, politikanët dhe shoqëria, janë një hap me tej drejt gjetjes së zgjidhjeve për përmirësimin e pozitës së grave në të ardhmen.

Shpresojmë se ky raport do të kontribuojë në mbajtjen e kësaj çështjeje lartë në agjendën politike dhe do të frymëzojë të gjithë vendimmarrësit që ta përshpejtojnë progresin drejt barazisë gjinore në shoqërinë tonë.

PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në mes të traditës dhe modernitetit

Si votojnë gratë në Kosovë?

- Përfshirja më e madhe e gruas në jetën politike mund të ketë ndikim edhe në sjelljen e saj si votuese, pasi ajo nuk do ta shihte votimin më shumë si një çështje të baballarëve, bashkëshortëve dhe vëllezërve, por pjesë të rëndësishme të rolit të saj si grua.
- Gratë në Kosovë kryesisht votojnë për të njëjtën parti, gjë të cilën e dëshmon fakti se ato kishin votuar njëjtë edhe në dy palë zgjedhjet paraprake. Vendimin për partinë e marrin shumë kohë para fushatës elektorale. Pra, mund të thuhet se gratë i përkasin pjesës së elektoratit stabil. Vlen të përmendet edhe hezitimi për t'u deklaruar në mënyrë të hapur se cilën parti do ta votojnë në zgjedhjet e radhës, pasi mbi gjysma e të anketuarave kanë refuzuar të përgjigjen.
- Në raportin mes pjesëmarrjes politike dhe vendbanimit, përqindjet e respondenteve nga qytetet dhe fshatrat nuk ndryshojnë shumë mes veti (qytet: 49 për qind; fshat: 48.6 për qind; qytezë 2.4 për qind)
- Më shumë se gjysma e grave respondente janë deklaruar se aspekti gjinor, respektivisht angazhimi i partive të preferuara në çështjet e të drejtave të grave dhe të barazisë gjinore - nuk janë kriteri kryesor në vendimin për ta votuar një parti të caktuar.
- Duke pasur tri mundësi për të deklaruar se pse votojnë ashtu si votojnë, ato në opsionin e parë kanë theksuar se përcaktohen në bazë të fushatës elektorale, ose për shkak të zhgënjimit me parti tjera. Në opsionin e dytë, votën e tyre e përcakton besimi në lider të partisë, kurse vetëm në opsionin e tretë ato janë deklaruar se vendimin për ta votuar një parti të caktuar e marrin në bazë të programit partiak.

- Tri çështjet më urgjente, të kategorizuara në tri zgjedhje të mundshme, të cilat janë identifikuar nga gratë dhe vajzat e Kosovës si çështje me të cilat politikanët e zgjedhur duhet të merren në të ardhmen e afërt, janë:

Zgjedhja e parë:

- a) Zhvillimi ekonomik
- b) Zhdukja e varfërisë
- c) Dialogu Kosovë - Serbi

Zgjedhja e dytë:

- a) Papunësia
- b) Korrupsioni dhe sundimi i ligjit kanë marrë të njëjtën përqindje
- c) Krimi i organizuar

Zgjedhja e tretë:

- a) Varfëria
- b) Korrupsioni
- c) Papunësia

Informimi

- Niveli i informimit, për sa i përket njohurive lidhur me liderët e institucioneve më të rëndësishme të vendit, është mjaft i mirë. Po, kur është fjala për liderë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, njohuritë e të anketuarave janë dukshëm më të ulëta. Në anën tjetër, 41,9 për qind e grave kanë zgjedhur opsionin “Nuk e di” lidhur me atë se kujt i raportojnë liderët e institucioneve të Kosovës.
- Gjithashtu vërehet një mungesë e informacionit lidhur me buxhetin e Kosovës, ku vetëm 26,9 për qind kanë dhënë përgjigje të saktë për lartësinë e buxhetit të Kosovës për vitin 2013.
- Rreth opinionit që ka të bëjë me atë se cilat gra politike nga partitë parlamentare përfaqësojnë më së miri interesat e grave, respondentet kanë treguar njohuri të mira rreth punës së grave politike, duke identifikuar shumicën e grave deputete në Parlament dhe Ministret të cilat kanë qenë më të zëshme në publik për një sërë çështjesh që janë ngritur dhe konsiderohen çështje specifike të grave.
- Ndonëse edhe më tej gratë në Kosovë burim kryesor të informacionit e kanë televizionin, një risi që duhet veçuar në krahasim me hulumtimin e kaluar (

Si votojnë gratë në Kosovë?

Si Votojnë Gratë? 2005) është se mbi 30 për qind e të anketuarave në vend të dytë si burim i informacionit për aktualitete përdorin internetin dhe rrjetet sociale, si Facebook.

Situata personale

- Niveli i shkollimit të grave dhe vajzave mbetet sfida për institucionet e arsimit në Kosovë për faktin se vetëm 15 për qind e respondenteve thonë se e kanë të kryer shkollimin universitar, ndërsa 37,1 për qind kanë shkollim të mesëm.
- Deklarimi i mbi 14 për qind të të anketuarave se aktualisht janë studente verifikon përqindjen e të diplomuarave (15 për qind) dhe njëkohësisht dëshmon nevojën për rritje të numrit të vajzave me diplomë universitare.
- Gjithashtu është dekurajues fakti se vetëm afro 32 për qind e grave të anketuara janë të punësuar, ndërsa pjesa tjetër deklarohen si shtëpiake, ose të papunësuar.
- Në anën tjetër, të pyetura lidhur me kënaqshmërinë me situatën financiare familjare, përqindjen më të madhe e marrin opsionet “shumë e kënaqshme” 17.4 për qind, dhe “e kënaqshme”, 74.6 për qind, gjë që jep një pasqyrë interesante të disponimit pozitiv përkundër papunësisë së theksuar të tyre.

Qëndrimet për rolin e gruas

- Në disa raste gratë e anketuara shfaqin tendencë për qëndrime tradicionale lidhur me rolin e grave në shoqëri, posaçërisht në politikë, pasi një numër i madh i tyre mendojnë se gratë e kanë më të rëndësishme familjen se karrierën politike. Por, në anën tjetër ato gjithashtu shprehin pikëpamje progresive duke shprehur nevojën e rritjes së numrit të grave të përfshira në politikë dhe vendimmarrje, në të dy nivelet e pushtetit.
- Të pyetura se cili do të duhej të ishte numri i grave në pozita vendimmarrëse, 40 për qind e tyre janë deklaruar se “**rreth gjysma e pozitave vendimmarrëse duhet t’iu takojnë grave**”, qëndrim ky i qartë në favor të barazisë gjinore në shoqërinë tonë.
- Gratë janë mjaft skeptike sa i përket përvojës, vetëbesimit dhe interesimit të grave që në mënyrë të suksesshme të ndërtojnë karrierë politike sepse konsiderojnë se gratë politike nuk e kanë përkrahjen e duhur nga partitë të cilave iu përkasin.

Sistemi zgjedhor

- Të pyetura për arsyeshmërinë e aplikimit të kuotës gjinore në politikë, ku partitë politike sipas ligjit janë të obliguara që në zgjedhje të kenë një të tretën e kandidatëve gra, shumica e grave të intervistuar (mbi 70 për qind), janë në favor të aplikimit të saj. Ato gjithashtu janë deklaruar se parapëlqejnë votimin me lista të hapura, siç edhe është momentalisht në Kosovë. Po kështu janë deklaruar edhe në hulumtimin e kaluar (Si Votojnë Gratë në Kosovë 2005) - Gratë janë të qarta edhe sa i përket mënyrës së zgjedhjes së Presidentit/es së Republikës së Kosovës, pasi mbi 80 për qind e tyre janë deklaruar për opsionin e zgjedhjes së drejtpërdrejtë nga qytetarët e Kosovës.

REKOMANDIMET

- Raporti ka për qëllim të rrisë vetëdijen e publikut dhe institucioneve për situatën aktuale mbi pozitën e grave në shoqërinë kosovare. Qendra Kosovare për Studime Gjinore shpreson se rekomandimet në vijim do të kontribuojnë në arritjen e këtij qëllimi:
- Të krijohen dhe zbatohen politikat e punësimit të cilat do të kontribuonin në rritjen e nivelit të punësimit të grave dhe vajzave të reja në mënyrë që të rritet niveli i përfshirjes sociale të tyre.
- Të investohet në fuqizimin ekonomik të grave, duke inkurajuar dhe mbështetur ndërmarrësinë e grave. Nevojitet angazhim shtesë nga ana e Qeverisë që të adresohet varfëria e grave dhe joaktiviteti i tyre në tregun e punës.
- Të rritet niveli i informimit të grave për punën e politikaneve, institucioneve dhe mbi të drejtat e tyre.
- Të rritet niveli dhe cilësia e komunikimit, konsultimit dhe bashkëpunimit në mes të grave politikane dhe votueseve.
- Mediat të ofrojnë më shumë hapësirë për fushatat senzibilizuese që kanë për qëllim eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.
- Organizatat të cilat bëjnë monitorimin e rregullt të mediave në Kosovë ta përfshijnë perspektivën gjinore në analizat e tyre.

Si votojnë gratë në Kosovë?

- Gjatë fushatave zgjedhore të monitorohen mediat në të gjitha segmentet e saj (edicionet informative, intervistat, debatet, ballinat/faqet e para të gazetave, kronikat zgjedhore, etj.) lidhur me prezantimin e grave politike.
- Rritja e nivelit të përfaqësimit të grave në vendimmarrje, politikë dhe sektorët tjerë të shoqërisë.
- Promovimi dhe fuqizimi i lidershipit të grave në nivelin lokal të qeverisjes.
- Kuotat gjinore duhet të mbeten si mekanizem efektiv i rritjes së përfaqësimit politik të grave.
- Kuota gjinore të aplikohet jo vetëm në përfaqësimin politik, por edhe në strukturat vendimmarrëse në partitë politike.
- Organizatat e grave dhe mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore të organizojnë aktivitet edhe fushata sensibilizuese të cilat do të kontribuojnë në adresimin e çështjeve të cilat kanë të bëjnë me rolet dhe relacionet gjinore, si dhe promovimin e vlerave të cilat fuqizojnë barazinë gjinore.

REZULTATET E HULUMTIMIT

PASQYRA FAMILJARE E RESPONDENTEVE

Mostra e hulumtimit të QKSGJ-së ishte 1050 gra dhe vajza, prej tyre janë anketuar 49,9 për qind në fshatra dhe 47,3 për qind në qytete, ndërsa 2,6 për qind në qyteza. Sa i përket statusit martesor, 66,6 për qind janë të martuara, të pamartuara janë 30,4 për qind, ndërsa të veja 2,7 për qind. Niveli i shkollimit të grave dhe vajzave në Kosovë mbetet sfidë për institucionet e arsimit në Kosovë për faktin se vetëm 15 për qind e respondenteve thonë se e kanë të kryer shkollimin universitar, ndërsa 37,1 për qind kanë shkollim të mesëm. Deklarimi i mbi 14 për qind të të anketuarave se aktualisht janë studente verifikon përqindjen e të diplomuarave dhe njëkohësisht dëshmon mungesën e progresit drejt rritjes së numrit të vajzave me diplomë universitare. 28,9 për qind e respondenteve kanë deklaruar se janë me shkollim fillor, 1,8 për qind me master, 0,3 për qind me doktoratë dhe 2,3 për qind janë pa asnjë vit shkollë. Kjo gjendje në fushën e arsimit ndikon dukshëm në pozitën e vështirë ekonomike dhe sociale në të cilën gjenden gratë dhe vajzat në Kosovë.

Është dekurajues niveli i punësimit të grave në Kosovë, ku sipas shifrave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës shkalla e papunësisë për gratë është 55,5%, kundrejt 40,5% të meshkujve. Ndërkaq, 49,4% e grave të punësuara punojnë në sektorin publik.

Kjo gjendje në tregun e punës pasqyrohet edhe nga hulumtimi i QKSGJ-së, ku gratë e anketuara deklarojnë se 14,4 për qind janë të punësuara në sektorin privat, 9,3 për qind në sektorin publik, 8,2 për qind të vetëpunësuara, 7,7 për qind punojnë kohë pas kohe, 2,6 janë pensioniste, ndërsa shtëpiake deklarohen 32 për qind dhe të papuna 25,8 për qind. Joaktiviteti ekonomik i grave është i dukshëm, sepse rreth 75 për qind e grave në moshë pune as nuk kërkojnë punë.¹

Në anën tjetër, të pyetura lidhur me kënaqshmërinë me situatën financiare familjare, përqindjen më të madhe e marrin opsionet “shumë e kënaqshme” 17,4 për qind dhe “e kënaqshme” 74,6 për qind, gjë që jep një pasqyrë të disponimit pozitiv përkundër papunësisë së theksuar të tyre.

Lidhur me vendimmarrjen në kuadër të familjes, 54,3 për qind e grave shprehen se janë “të kënaqura” me peshën e tyre vendimmarrëse, “shumë të kënaqura” janë 33,6 për

¹ Agon Maliqi, Sa të rralla gratë e punësuara!, Gazeta JNK, 23 Shtator, 2013, www.gazetajnk.com/index.php?cid=1,1067,6485

Si votojnë gratë në Kosovë?

qind, ndërsa 8,4 për qind janë “as të kënaqura, as të pakënaqura”, dhe vetëm 2,9 për qind “të pakënaqura” .

Edhe pse nga shumica e përgjigjeve duket qartë se gratë dhe burrat vendosin së bashku për shumë çështje familjare, një përqindje më e lartë e vendimmarrjes së grave shihet tek vendimet për arsimimin e fëmijëve -22,3 për qind, në krahasim me 2,8 për qind të burrave, apo tek vendimet që kanë të bëjnë me punët e përditshme të shtëpisë (pastrimi, përgatitja e ushqimit për familje, pazari i shtëpisë) me 47,3 për qind, në krahasim me 6,2 për qind të burrave.

Mirëpo, kur është fjala për shpenzimet e mëdha në familje, pasqyra e vendimmarrjes ndryshon. Burrat kanë fuqi më të madhe vendimmarrëse krahasuar me gratë kur vendoset për shpenzime të mëdha, gjë që e ilustron fakti se 19,2 për qind e burrave kundrejt 6,6 për qind të grave vendosin për shpenzime të mëdha siç janë blerja e veturës, shtëpisë, banesës, tokës, etj.

INFORMIMI

Gratë në Kosovë edhe më tej burim kryesor të informacionit e kanë televizionin, mirëpo një risi që duhet veçuar në krahasim me hulumtimin e kaluar është se 35.8 për qind e të anketuarave në vend të dytë si burim të informacionit për aktualitete përdorin internetin, apo rrjetet sociale (Facebook).

Mjetet tjera të informimit si radioja, gazetatat, web portalet, përdoren dukshëm më pak nga gratë si burime të informacionit. Vetëm 9.8 për qind e grave kanë theksuar se marrin informacione nga radioja, 3 për qind nga gazetatat, ndërsa 1 për qind nga web portalet.

Burimi	Rrallë (1-2 herë në javë)	Shpesh (3-5 herë në javë)	Rregullisht (Çdo ditë)
Gazeta	51.7%	17.0%	6.2%
Interneti	21.5%	28.3%	35.8%

Televizioni	7.2%	29.6%	61.1%
Radio	44.0%	24.5%	9.8%
Biseda me familje	16.9%	55.3%	23.9%
Biseda jashtë familjes (shoqëria etj.)	43.9%	37.7%	8.1%
Web portalet	23.7%	26.3%	16.1%
Facebook	12.9%	18.3%	31.0%

Njohuritë për bartësit e institucioneve

Niveli i informimit lidhur me liderët e institucioneve më të rëndësishme të vendit është mjaft i mirë: 76 për qind e grave pohuan se Atifete Jahjaga është Presidente e Kosovës, 77 për qind dinin se Kryeministër i Kosovës është Hashim Thaçi, 70,4 për qind e grave të anketuara përmendën emrin e Jakup Krasniqit si Kryetar i Parlamentit të Kosovës. Është fakt interesant që gratë në masë prej 64,8 për qind pohuan se nuk dinë se kush është shefi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, që ndoshta mund të shpjegohet me ndryshimin e emrit nga TMK në FSK, por edhe me mosinteresimin e grave për çështje që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë në kuptimin tradicional.²

Mirëpo, kur është fjala për liderë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, njohuritë e të anketuarave janë dukshëm më të ulëta. Në pyetjen se kush është në krye të misionit të EULEX, 89,9 për qind e të anketuarave pranojnë se nuk e dinë, dhe vetëm 1,2 për qind përmendin Bernd Borchardt.

Raportet ndërinstytucionale dhe llogaridhënia


Të pyetura se kujt i raportojnë liderët e institucioneve të Kosovës, vërehet një mungesë e përgjithshme e njohurive për atë se kush kujt i jep llogari për punën e institucioneve të cilat i drejtojnë.

² Në Kosovë, si edhe në vende të tjera të botës, koncepti tradicional i sigurisë nënkupton dy faktorët kryesorë të sigurisë së vendit: ushtrinë dhe policinë. Raporti QKSGJ "Monitorimi i sigurisë nga perspektiva gjinore" Dhjetor 2007, Prishtinë


Si votojnë gratë në Kosovë?

Opsionin “Nuk e di” e kanë zgjedhur 41,9 për qind e grave lidhur me pyetjen se kujt i raporton Forca e Sigurisë së Kosovës, si dhe 23.1 për qind prej tyre nuk e dinë se kujt i raporton Kuvendi i Kosovës.

Forcat e sigurisë i raportojnë




Kuvendi i Kosovës i raporton




Gjithashtu vërehet një mungesë e dukshme e informacionit lidhur me faktet për Kosovën, siç është për shembull, pyetja për buxhetin e Qeverisë së Kosovës, ku vetëm 26,9 për qind kanë dhënë përgjigje të saktë për lartësinë e buxhetit të Kosovës për vitin 2013.

A mund të na tregonisa është buxheti i Kosovës



Gjithashtu, të pyetura se sa vende ka Parlamenti i Kosovës dhe cila është përqindja e grave në Parlament, 39.7 për qind e tyre nuk e kanë ditur sa ulëse ka Parlamenti, kurse 33.7 për qind kanë qenë të sakta për përqindjen e grave parlamentare.

Sa përqind e deputeteve në Kuvendin e Kosovës janë gra?



Nevoja e ngritjes së nivelit të përfshirjes së drejtpërdrejtë të grave në çështjet e

Si votojnë gratë në Kosovë?

politikave publike dhe institucionale është shumë e qartë, bazuar në të dhënat e prezantuara më lartë.

Duhet hartuar strategji informuese dhe integruese të cilat do të rrisnin interesin e grave në këtë sferë në mënyrë që të motivohen për t'u edukuar më shumë për çështjet të cilat prekin jetën e tyre, siç është p.sh., buxheti, llogaridhënia institucionale apo çështje të tjera të kësaj natyre.

QËNDRIMET MBI ROLIN E GRUAS

NË FAMILJE DHE SHOQËRI

Në këtë seksion janë marrë qëndrimet e grave lidhur me çështjet e familjes, rolin e grave në familje dhe shoqërinë kosovare. Në këtë mënyrë përmes hulumtimit kemi synuar të shohim pikëpamjet e tyre lidhur me martesën, bashkëjetesën, rolet gjinore në familje, aborti selektiv, dhuna, trashëgimia, etj.

Nga një numër përgjigjesh në pyetjet e shtruara mund të bëhet një konstatim i përgjithshëm se shoqëria kosovare ende mund të karakterizohet si një shoqëri me vlera tradicionale, sidomos për rolet gjinore, ndërsa më pak tradicionale kur bëhet fjalë për punësimin e grave.

Mendimet e respondentëve rreth deklaratave të radhitura në tabelë.

Nr	DEKLARATA	PO	JO	ASHTU	NUK E DI	Ref/PP
1	Është e natyrshme që pjesa më e madhe e punëve të shtëpisë janë detyrë e gruas	64.9%	26.1%	7.7%	1.3%	
2	Nuk ka asgjë të keqe nëse një çift jeton së bashku pa dashur të martohet	34.9%	50.3%	8.6%	6.0%	0.2%
3	Një fëmijë parashkollorë ka gjasa të pësojë në zhvillim nëse nëna e tij punon	36.4%	38.9%	19.1%	5.6%	
4	Kujdesi për fëmijët është më tepër detyrë e nënës sesa e babait	42.9%	35.0%	18.4%	3.4%	0.3%
5	Edhe burri edhe gruaja duhet të kontribuojnë në të ardhurat e familjes	78.6%	8.6%	10.1%	2.4%	0.3%
6	Detyra e burrit është që të fitojë para kurse detyra e gruas është që të kujdeset për familjen dhe punët e shtëpisë	26.0%	56.1%	14.4%	3.4%	0.1%

7	Femrat kanë më shumë prirje të jenë menaxherë/drejtorë sesa meshkujt	34.7%	25.3%	24.1%	15.5%	0.4%
8	Burrat duhet të punojnë në shtëpi më shumë sesa punojnë tani	44.4%	23.5%	23.7%	7.8%	0.6%
9	Është shumë me rëndësi që burri të vishet dhe të sillet si burrë dhe gruaja të vishet dhe të sillet si grua	67.3%	16.8%	10.3%	5.3%	0.3%
10	Kur gruaja fiton më tepër sesa burri i saj, kjo gjithmonë shkakton problem	16.3%	57.4%	17.1%	8.9%	0.3%
11	Arsimi universitar është më i rëndësishëm për një vajzë sesa për një djalë	40.3%	41.3%	14.0%	4.2%	0.2%
12	Në përgjithësi meshkujt janë liderë më të mirë politik sesa femrat	36.9%	40.6%	16.4%	5.8%	0.3%
13	Nëse një kompani duhet të pushojë punëtorë nga puna, më mirë është që të pushohen gratë e martuara sesa meshkujt	27.2%	52.7%	10.6%	9.2%	0.3%
14	Kujdesi ndaj të moshuarve dhe të sëmurëve në familje, është obligim i mashkullit	22.0%	56.5%	17.3%	3.9%	0.3%
15	Babai dhe nëna duhet të vendosin se për kë të martohen fëmijët e tyre, e për kë jo	14.8%	69.1%	12.2%	3.8%	0.1%
16	Djemtë janë trashëgimtarët e vetëm të pasurisë familjare	30.2%	51.6%	13.7%	4.3%	0.2%
17	Fëmijët kanë nevojë për babanë edhe kur ushtron dhunë kundër nënës së tyre	32.0%	45.3%	14.9%	7.0%	0.8%
18	Aborti selektiv ndihmon planifikimin familjar	12.8%	71.1%	6.0%	9.1%	1.0%

Në një shoqëri ku burrat ende në një masë të madhe përfaqësojnë sferën publike dhe gratë ende në masë të madhe përfaqësojnë sferën private, qëndrimet e prezantuara nga gratë e anketuara nuk do duhej të merren si befasi. Të pyetura për qëndrimin e tyre lidhur me pikëpamjen se **“Për gratë më e rëndësishme është familja se karriera në politikë”**, 62,2 për qind e grave pajtohen se familja është më e rëndësishme se karriera politike, ndërsa 28,7 për qind e tyre nuk pajtohen. Pikëpamjet e grave për rolin e gruas dhe të burrit në familje, si dy role të ndara, pasqyrohen edhe në përgjigjet tjera si **“Kujdesi për fëmijët është më tepër detyrë e nënës sesa e babait”**, ku 43,6 për qind janë pajtuar me këtë qëndrim. Por, krahasuar me hulumtimin e kaluar, në të cilin 56,2 për qind të grave ishin pajtuar me të njëjtin qëndrim, vërehet një tendencë drejt ndryshimit gradual të pikëpamjeve tradicionale lidhur me rolin e grave në familje.

Në të njëjtën kohë, për disa çështje dhe sjellje në familje gratë e anketuara tregojnë pikëpamje më moderne, ku p.sh., në pyetjen se **“babai dhe nëna duhet vendosur për**

Si votojnë gratë në Kosovë?

kë martohet vajza e tyre, e për kë jo” 67,8 për qind deklarohen kundër këtij qëndrimi. Por, nuk janë kaq të hapura kur vjen fjala për bashkëjetesën, ngase 52, për qind e grave nuk pajtohen me qëndrimin se **“Nuk ka asgjë të keqe nëse një çift vendos të jetojë së bashku pa dashur të martohen”**.

Inkurajuese janë dhe pikëpamjet e grave për sa i përket abortit selektiv, ku 67,8 për qind e grave nuk janë pajtuar me qëndrimin se **“Aborti selektiv ndihmon planifikimin familjar”** si dhe për sa i përket trashëgimit të pasurisë familjare ku në pyetjen se **“djemtë janë trashëgimtarët e vetëm të pasurisë familjare”** 49,2 për qind janë kundër këtij qëndrimi ndërsa 29,6 për qind pajtohen derisa 15,5 janë deklaruar se as pajtohen as nuk pajtohen.

Po ashtu, shumë gra respodente 44.9 për qind nuk janë pajtuar me modalitetin **“Fëmijët kanë nevojë për babanë edhe kur ushtron dhunë kundër nënës së tyre”**, për dallim nga 31.6 për qind të cilat janë pajtuar me të.

ROLI I GRUAS NË SHOQËRI

Në të kaluarën, tradicionalisht, burrat kanë punuar jashtë shtëpisë dhe kanë qenë mbajtës të vetëm të familjes. Gratë, në anën tjetër, kanë qeverisur sferën familjare dhe nga ato është pritur të qëndrojnë në shtëpi për të rritur fëmijët, për t'u kujdesur për pleqtë dhe për ushqimin, punët e shtëpisë, etj.

Mirëpo, që nga koha kur gratë kanë hyrë në tregun e punës, rolet e grave dhe burrave në shoqëri kanë ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme për dekada gjithandej nëpër botë, dhe këto ndryshime janë shënuar edhe në shoqërinë kosovare. Sidoqoftë, rolet gjinore, rrjedhimisht roli i grave në shoqërinë kosovare, po ndryshojnë, por me tempo të ngadaltë dhe kjo gjendje po pasqyrohet edhe në qëndrimet e grave të anketuara për këtë hulumtim. Ato për disa aspekte shprehin pikëpamje tradicionale duke u përcaktuar për qëndrimin se **“burrat janë liderë politikë më të mirë sesa gratë”**, me 41,9 për qind. Po kështu, edhe në pyetjen se **“është shumë me rëndësi që burri të vishet dhe sillet si burrë dhe gruaja duhet të vishet dhe sillet si grua”**, 67,2 për qind e kanë pohuar këtë qëndrim dhe vetëm 18,2 për qind prej tyre nuk janë pajtuar. Mirëpo, në disa aspekte vërehet se gratë nuk janë për role të ndara në mënyrë aq rigorozë dhe kanë qëndrime më egalitare kur flitet për punësimin, kujdesin për fëmijët dhe punët e shtëpisë. Kështu, 59 për qind nuk pajtohen me qëndrimin se **“detyra e burrit është të fitojë para, ndërsa detyra e gruas është që të kujdeset për familjen dhe punët e shtëpisë”**. Gjithashtu, në pyetjen se **“Nëse një kompani duhet të pushojë punëtorë nga puna, më mirë është që të pushohen gratë e martuara se meshkujt”**, gratë janë deklaruar kundër këtij qëndrimi me 55,2 për qind, pajtohen 24,3 për qind ndërsa as pajtohen as nuk pajtohen 10,4 për qind. Gratë mendojnë se edhe burri edhe gruaja duhet të kontribuojnë në të ardhurat e familjes sepse ato janë deklaruar në favor të këtij qëndrimi në masë prej 78,9 për qind. Pra, derisa për çështjet siç janë ndarja e punëve të shtëpisë, në mes burrit e gruas, gratë e anketuara kanë shfaqur qasje më tradicionale, kur është fjala për punësimin e gruas dhe kontributin e tyre në të ardhurat e familjes ato

kanë qasje më pak tradicionale duke u përcaktuar për rol shumë më aktiv në shoqëri. Edhe pse roli i gruas në shoqërinë kosovare po ndryshon, balancimi në mes të punës dhe obligimeve familjare është çështje që preokupon çdo grua e cila punon dhe që ka familje. Në rastin tonë, sistemi i përkujdesjes për fëmijët dhe të moshuarit është ende në nivel të ulët të zhvillimit dhe i pamjaftueshëm për të mbështetur gratë të cilat punojnë. Gratë e punësuar ende mbajnë barrën e dyfishtë të punësimit dhe punëve të shtëpisë, që veç tjerash nënkupton kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve.

QËNDRIMET E GRAVE MBI ROLIN E SHTETIT

NË EKONOMI DHE SHOQËRI

Shoqëria kosovare që nga vitet e 90'ta është një prej vendeve post-komuniste e cila po kalon një fazë tranzicioni të ndryshimeve sociale dhe sistemore. Në këtë pjesë të hulumtimit, qëllimi ka qenë që të bëjmë një vlerësim të qëndrimeve të grave lidhur me atë se si ato e shohin rolin e shtetit në ekonomi dhe shoqëri në rrethanat aktuale të tranzicionit.

Pikëpamjet e tyre rreth këtyre çështjeve duket të jenë mjaft ambivalente: në njërin anë ato kanë pikëpamje që për afrohen me pikëpamje të një shteti social ku shteti duhet të marrë përgjegjësi për mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj dhe krijon politika të cilat sigurojnë kujdes shëndetësor dhe arsimor falas, asistencë financiare për të papunët, etj. Kjo më së miri pasqyrohet tek përgjigjet në qëndrimin **“shteti duhet t'u sigurojë të gjithë qytetarëve falas arsimin dhe shërbimet shëndetësore”**, ku 64,6 për qind pajtohen me këtë qëndrim, ndërsa vetëm 13,1 për qind nuk pajtohen dhe 13,8 për qind që as pajtohen as nuk pajtohen. Në mbështetje të këtij konstatimi është edhe pikëpamja e tyre për rolin e fortë të sindikatave në organizata punuese ku shumica e tyre me 78 për qind mendojnë se **“të punësuarve u nevojiten sindikata të fuqishme që t'i mbrojnë kushtet e tyre të punës dhe rrogat”**. Ndërsa në anën tjetër kemi qëndrime që përkohë më shumë me konceptin e ekonomisë së tregut dhe që më nuk janë aq të prera kur bëhet fjalë për pikëpamjet e tyre për rëndësinë e zhvillimit ekonomik edhe nëse shkon në dëm të shërbimeve publike, 45,9 për qind e grave janë kundër këtij qëndrimi mirëpo nuk është i vogël numri i grave që pajtohen me këtë qëndrim në masë prej 30,7 për qind. Gjithashtu, përkundër kritikave të vazhdueshme ndaj procesit të privatizimit në Kosovë, 32,3 për qind e grave janë pajtuar se **“pa privatizim, firmat do të jenë më keq në të ardhmen se që janë tash”** ndërsa 26,8 për qind nuk janë pajtuar dhe 14,4 për qind as nuk janë pajtuar as pajtuar.

Kjo fazë e tranzicionit po përcillet edhe me nivel të lartë të papunësisë prandaj edhe solidariteti tradicional i familjeve kosovare për të ndihmuar familjet e tyre në vështirësi ekonomike ende është shumë i shprehur. Kryesisht ndihma vjen nga emigrantët të cilët vazhdojnë të mbështesin familjet e tyre në Kosovë edhe përkundër krizës ekonomike globale³. (Prandaj dhe të pyetura se **“nëse një anëtar i familjes së gjerë ka gjendje materiale shumë më të mirë se të tjerët, ka obligim t'i ndihmojë ata materialisht”**,

3 Gjatë vitit 2013, shtetasit kosovarë që jetojnë në emigracion, kanë dërguar drejt vendit të tyre 621 milionë euro. www.telegraf.com/ekonomi/remitencat-ne-kosove-me-te-larta-se-ne-shqiperi-46-18773.html).

Si votojnë gratë në Kosovë?

gratë janë pajtuar me këtë qëndrim me 38,3 për qind mirëpo është e lartë për qindja e grave të cilat nuk pajtohen me këtë pohim me 32,6 për qind dhe 19,8 për qind as pajtohen as nuk pajtohen. Përgjithësisht, tek gratë nga përgjigjet në pyetjet e shtruara vërehet një lloj paqartësie dhe pasigurie rreth çështjeve për rolin e shtetit në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit duke përzgjedhur shpesh edhe opsionin “nuk di”, ndërsa shumë më të qarta janë kur pyetjet janë të lidhura me çështjet e mirëqenies së familjeve të tyre që mund të shpjegohet me rolin e saj tradicional në familje.

Mendimet e respondentëve rreth deklaratave të radhitura në tabelë

Nr	DEKLARATA	PO	JO	ASHTU	NUK E DI	Ref/ PP
1	Zhvillimi ekonomik i vendit është qëllimi kryesor, edhe kur është në dëm të shërbimeve publike	32.1%	45.7%	10.0%	11.8%	0.4%
2	Të punësuarve ju nevojiten sindikata që t'i mbrojnë kushtet e tyre të punës dhe rogat	77.6%	6.4%	9.2%	6.7%	0.1%
3	Qeveria duhet të ndërmarrë masa për zvogëlimin e dallimeve në të ardhura	62.7%	9.1%	18.2%	9.8%	0.2%
4	Pa privatizim, firmat në të ardhmen do të jenë edhe më keq sesa janë tash	28.2%	30.9%	15.1%	25.1%	0.7%
5	Gjithmonë është gjë e keqe që punëtorët të marrin pjesë në udhëheqjen e ndërmarrjeve	27.5%	32.3%	19.3%	20.7%	0.2%
6	Shteti duhet t'u sigurojë të gjithë qytetarëve falas arsimin dhe shërbimet shëndetësore	65.1%	15.3%	11.2%	8.3%	0.1%
7	Nëse një anëtar i familjes së gjerë ka gjendje materiale shumë më të mirë se të tjerët, ka obligim që t'i ndihmojë ata materialisht	41.4%	31.1%	18.6%	8.9%	
8	Qeveria duhet të planifikojë buxhet të përgjithshëm gjinor	70.0%	9.6%	9.6%	10.1%	0.7%


QËNDRIMET MBI ROLIN E GRUAS NË POLITIKË

Përkundër treguesve pozitivë, siç është aplikimi i kuotës prej 30 për qind, mbeten sfida të konsiderueshme në pjesëmarrjen kuptimplote të grave në politikë. Ato ballafaqohen me mungesë të fuqisë vendimmarrëse në institucione dhe brenda partive politike, gjë që e dëshmon edhe përvoja e gjertanishme ku lidhshipi është ende shumë i centralizuar në duar të burrave liderë të partive politike.

Gratë angazhohen shumë pak edhe në proceset zgjedhore si zyrtare zgjedhore, pasi sipas një analize të zgjedhjeve të vitit 2013 në Kosovë, vetëm 17 për qind kanë qenë gra të përfshira në KKZ, KVV dhe MQV⁴.


Nga rezultatet e hulumtimit del se gratë janë mjaft të qarta për faktin se shoqëria kosovare dhe partitë politike nuk janë shumë përkrahëse ndaj grave politikane dhe se ato në rrethana më të favorshme dhe të inkurajuara nga të tjerët do të kishin qenë po aq të suksesshme sa edhe burrat.

Në Kosovë, femrat në politikë mund të kenë sukses:



Grafikoni paraparak pasqyron faktin se një numër i madh i grave në masë prej 45,9 për qind mendojnë se gratë në politikë përgjithësisht janë të diskriminuara, mirëpo në anën tjetër një përqindje mjaft e lartë prej 33,2 për qind e grave nuk e ndajnë të njëjtin mendim. Këto të dhëna që pasqyrojnë dallime në opinione për këtë çështje mund të interpretohen edhe si rezultat i një debati të vazhdueshëm në shoqërinë tonë për rolin e grave në politikën kosovare.

Në përgjithësi gratë diskriminohen në jetën politike




Ndonëse perceptimet e votueseve për gratë politike po ndryshojnë, prapëseprapë gratë politike ende duhet të luftojnë për “kredibilitet” krahasuar me meshkujt në politikë. Ato vazhdojnë të shihen si më pak të fuqishme politikisht dhe në këtë perceptim mediat luajnë një rol të rëndësishëm në stereotipizimin e grave politike me mënyrën se si i pasqyrojnë.⁵

Të pyetura për qëndrimin e tyre se **“vetëm disa gra meritojnë çdo respekt, ndërsa shumica nuk e arsyetojnë besimin e votuesve”, përgjigjet e tyre janë si vijon: 34,2 për qind pajtohen, 29,7 për qind nuk pajtohen, ndërsa 24 për qind përgjigjen “ashtu”.**

Me qëndrimin se **“gratë nuk e kanë përvojën e domosdoshme për t’u marrë me politikë”**, ato pajtohen me 20,1 për qind, ndërsa 46,4 për qind nuk pajtohen ndërsa “as nuk pajtohen, as pajtohen” me këtë qëndrim janë 17,3 për qind.

⁵ Raporti QKSGJ“Imazhi i grave politike në media kosovare” Qershor 2009, Prishtinë

Gratë nuk e kanë përvojën e duhur për tu marrë me politikë




Rreth opinionit që ka të bëjë me atë se cilat gra politike nga partitë parlamentare të Kosovës i përfaqësojnë më së miri interesat e grave, respondentet kanë treguar njohuri të mirë rreth punës së grave politike nga partitë më të mëdha parlamentare. Ato kanë identifikuar me emër gratë deputete në parlament dhe ministre të cilat kanë qenë më të zëshme në publik për një sërë çështjesh të cilat janë ngritur nga ato. Gratë e anketuara janë pyetur se "Cila grua nga partia PDK, LDK, VV, AAK, AKR, përfaqëson më së miri interesat e grave?". Vlora Çitaku me 56,4 për qind ka dalë gruaja më e besuar në mesin e pesë grave bashkëpartiake, në LDK, Teuta Sahatqija me 46,6 për qind, në Lëvizjen Vetëvendosje Albulena Haxhiu me 62,5 për qind, në AAK Donika Kadaj Bujupi me 89 për qind, dhe në AKR Mimoza Kusari Lila me 80 për qind.

Që nga vitin 2011, Kosova ka për Presidente Atifete Jahjagën dhe në këtë mënyrë Kosova u rendit ndër vendet e pakta të botës që kanë për presidente një grua. Duke qenë se Kosova për herë të parë ka një grua në pozitën më të lartë shtetërore, ka qenë me interes të marrim mendimin e grave dhe vajzave të reja se si e vlerësojnë punën e gjertanishme të saj dhe në veçanti kënaqshmërinë e tyre me përfaqësimin e interesave të grave dhe vajzave në Kosovë. Në pyetjen se **"sa jeni të kënaqura me punën e deritanishme të Presidentes së Kosovës"**, Për punën e saj, respondentet janë shprehur shumë të kënaqura me 5,5 për qind, të kënaqura me 35,6 për qind, as të kënaqura as të pakënaqura janë shprehur 47,6 për qind, ndërsa plotësisht të pakënaqura janë 11,3 për qind të tyre. Të pyetura për vlerësim për kontributin e Presidentes në përfaqësimin e interesave të grave në vend, ato janë shprehur se janë "shumë të kënaqura" me 5,8 për qind, "të kënaqura" me 32,5 për qind, "as të kënaqura, as të pakënaqura" janë 50,7 për qind të grave ndërsa "plotësisht të pakënaqura" janë 11 për qind e grave të anketuara.

Mënyra e Zgjedhja e Presidentit/es

Aktualisht, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti/ja e vendit zgjidhet nga Parlamenti me votë të fshehtë nga dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Mirëpo ka pasur debate për nevojën për ndryshime kushtetuese që u përcollën edhe me propozime për amendamente në bazë të të cilave propozohet që zgjedhja e Presidentit/es së vendit të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt përmes votës së qytetarëve. Arsyetimet për këtë mënyrë të zgjedhjes së drejtpërdrejt të Presidentit/es së vendit nga votat e qytetarëve ishin se në këtë mënyrë do të shmangeshin krizat eventuale politike; do t'i jepte më shumë legjitimitet; si dhe do të shmangte kalkulimet me numra të votave të deputetëve, dhe në këtë mënyrë do të përfaqësonte unitetin kombëtar. Këto amendamente nuk janë miratuar nga Kuvendi i kaluar i Kosovës por pritet që në kuadër të ndryshimeve tjera kushtetuese të aprovohet ndryshimi në legjislaturën pasuese. Në vazhden e këtij diskutimi, ekipi i QKSGJ-së i ka pyetur gratë për mendim lidhur me preferencat e tyre për mënyrën e zgjedhjes së Presidentit/es të vendit.

Si duhet zgjedhur Presidenti i Kosovës



Nga përgjigjet e dhëna, gratë janë të qarta për sa i përket mënyrës së zgjedhjes së Presidentit/es së Republikës së Kosovës, ato me 89,1 për qind janë deklaruar për opsionin e zgjedhjes së Presidentit/es në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës.

Përfshirja më e madhe e grave në jetën politike mund të ketë ndikim edhe në sjelljen e saj si votuese e cila nuk do ta shihte votimin apo marrjen me politikë më shumë si një çështje të baballarëve, bashkëshortëve dhe vëllezërve të tyre, por si pjesë e rëndësishme e rolit të saj si grua.

Zgjedhjet e fundit për pushtetin lokal

Në fund të vitit 2013 u mbajtën zgjedhjet lokale në Kosovë. Këto zgjedhje në përgjithësi u cilësuan si të lira dhe demokratike si nga institucionet e vendit po ashtu edhe nga faktori ndërkombëtar dhe misionet vëzhguese të tyre si EU EOM (European Election Observation Mission) i cili i cilësoi këto zgjedhje në raportin e tyre preliminar, si hap pozitiv për demokracinë në Kosovë.

Këto zgjedhje për kryetarë të komunave dhe të Kuvendeve Komunale patën dy veçori. Së pari, ishin të parat të mbajtura në të gjithë territorin e Kosovës, duke përfshirë edhe katër komunat veriore me shumicë serbe, me ligjin e Kosovës. Së dyti, nga këto zgjedhje doli edhe kryetarja e parë grua – ajo e Komunës së Gjakovës.

Falë kuotës gjinore, nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve komunalë, 338 janë gra, kurse 665 burra, apo të shprehura në përqindje 34 për qind me 66 për qind në favor të burrave. Ndërsa prej 224 kandidatëve për kryetarë të komunave vetëm 9 kandidatë ishin gra, prej të cilave vetëm një kandidatë arriti të zgjidhej kryetare, dhe nga 38 komuna vetëm një kryetare e Asamblesë Komunale, në Gjiilan. Sado që duhet parë pozitivisht zgjedhjen e parë të një gruaje për kryetare komune në Kosovë, , disbalanca gjinore është e dukshme që në kandidim për kryetarë komunash,. Gjithashtu, pas konstituimit të asambleve dhe qeverive lokale, gratë janë të nën-përfaqësuara në pozita vendimmarrëse brenda komunave. Nga gjithsej 315 drejtori, 301 drejtori udhëhiqen nga burrat ndërsa 14 drejtori udhëhiqen nga gratë⁶

PRIORITETET E GRAVE

Mungesa e të dhënave për përbërjen demografike, respektivisht të numrit të saktë të votueseve gra të cilat marrin pjesë në zgjedhje, aktualisht pamundëson të kemi informacione lidhur me fuqinë votuese të grave në të përcaktuarit e rezultateve, siç është p.sh., rasti i zgjedhjeve të fundit në SHBA ku gratë ishin forca përcaktuese për fitoren e Barak Obamës. Sipas studimit të Center for American Progress në zgjedhjet e vitit 2012, 53 për qind e votuesve ishin gra, dhe gratë që votuan për Obamën përbënin një të tretën e gjithë trupit elektoral. Sipas këtij studimi, ato u përcaktuan për Obamën sepse konsideruan se ai ishte lideri i cili do të adresonte prioritetet e grave si ekonomia, shërbimet shëndetësore dhe aborti⁷.

Në bazë të rezultateve të hulumtimit, gratë në Kosovë kanë theksuar se cilat janë tre prioritetet e tyre. Ato në pyetjen e shtruar: "Nga aspekti i nevojave dhe interesave tuaja, cilat janë tri çështjet kryesore të cilat kërkojnë angazhim urgjent nga ana e përfaqësuesve të zgjedhur të Kosovës?"

në zgjedhjen e parë kanë listuar si prioritet të parë zhvillimin ekonomik me 50 për qind; çështja e dytë është varfëria me 16,9 për qind dhe si çështje të tretë dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit, me 6,4 për qind.

Nëse e krahasojmë me hulumtimin e kaluar (Si votojnë Gratë në Kosovë 2005), mund të konstatohet se zhvillimi ekonomik si prioritet nga vendi i dytë (39.3 për qind) del si prioritet i parë (57.8 për qind) në këtë hulumtim. Ndërsa tek papunësia vërehet një dallim më i madh krahasu me hulumtimin e kaluar, ku vetëm 7,6 për qind e grave kanë menduar se papunësia është prioritet, ndërsa aktualisht 40,8 për qind e grave përcaktohen për papunësinë si prioritet.

Është indikative se çështjet si pensionet e ulëta me vetëm 4,7 për qind dhe dhuna në familje me 1,6 për qind nuk konsiderohen si çështje për angazhim urgjent nga shteti. Këto përqindje të ulta, ku gratë shohin rolin e shtetit si vendimtar në zgjidhjen e tyre, pasqyrojnë botëkuptimin se çështja si dhuna në familje është ende problem i brendshëm familjar.

7 Si i ndryshojnë gratë rezultatit e zgjedhjeve, Margie Omero dhe Tara McGuinness Dhjetor, 2012 <http://cdn.americanprogress.org/wpcontent/uploads/2012/12/GenderGap-4.pdf>.

Prioriteter e grave sipas partive politike

	PDK	LDK	VV	AAK
Dialogu Prishtine-Beograd	6.1	5.1	4.7	3.1
Zhvillimi ekonomik	43.9	51.3	48.8	57.8
Ndotja e ambientit	8.3	6.8	2.3	1.6
Perfaqesimi ndërkombëtar i Kosoves	3.8	1.7	2.3	4.7
Njohjet e shtetit të Kosovës	2.3	1.7	0	1.6
Pensionet e ulëta	5.3	5.1	9.3	4.7
Varfëria	16.7.1	17.9	25.6	20.3
Analfabetizmi	0.8	0.9	0	0
Integrimi në Bashkimin Europian	0	0.9	0	1.6
Dhuna në familje	3	1.7	0	1.6
Korrupsioni	5.3	3.4	2.3	1.6
Mbrojtja shëndetësore	0	0	0	0
Pabarazia gjinore	0.8	0	0	0
Përkujdesja për fëmijë	0	0	0	0
Perkujdesja per personat e pesuar nga lufta	0	0	2.3	1.6
Papunësia	3	1.7	2.3	0
Veriu i Mitrovicës	0	0.9	0	0
Shërbimet publike të shtrenjta	0.8	0	0	0
Sundimi i ligjit	0	0.9	0	0

PREFERENCAT POLITIKE TË GRAVE

Gratë në Kosovë kryesisht votojnë për të njëjtën parti, gjë që e dëshmon fakti se ato kishin votuar njëjtë edhe në dy palë zgjedhjet paraprahe, dhe vendimin e marrin shumë kohë para fushatës elektorale. Pra, mund të thuhet se gratë i përkasin pjesës së elektoratit konsistent në preferencat e tyre politike, duke mos ndryshuar ndër vite partinë të cilën e votojnë.

Vlen të përmendet edhe hezitimi për t'u deklaruar në mënyrë të hapur se cilën parti do ta votojnë në zgjedhjet e radhës, ku mbi gjysma e të anketuarave refuzojnë të përgjigjen.

Sa i përket trendëve të votimit, vërehet një dallim në mes të votueseve të fshatit dhe qytetit, ku votueset e qytetit kanë më shumë tendencë për ta ndërruar partinë se gratë e fshatit; gratë e qytezave janë më afër preferencave të fshatit.

Në raportin mes pjesëmarrjes politike dhe vendbanimit, përqindjet e respondentëve nga qytetet dhe fshatrat nuk ndryshojnë shumë mes veti (qytet: 49 për qind; fshat: 48.6 për qind; qytezë 2.4 për qind)

Përgjigjet e respondentëve për vendimin se për cilën partido të votojnë është paraqitur në formë tabelare. Shih Tabelën e mëposhtme.

Vendimi për të votuar (në përqindje)

VENDIMI	PDK	LDK	VV	AAK
I kahershëm (më herët se para dy vjetëve)	56.7%	62.3%	31.3%	41.9%
Para fushatës zgjedhore	15.6%	23.2%	16.7%	20.9%
Gjatë fushatës zgjedhore	15.6%	5.8%	27.1%	27.9%
Disa ditë para zgjedhjeve (1-3 ditë)	1.1%	1.4%	6.3%	2.3%
Ditën e zgjedhjeve	0%	0%	2.1%	2.3%
Ref/PP	11.1%	7.2%	16.7%	4.7%

ARSYET

Duke i pasur tri mundësi për të deklaruar se pse votojnë ashtu si votojnë, ato në opsionin e parë kanë theksuar se përcaktohen në bazë të fushatës elektorale ose për shkak të zhgënjimit me parti tjera, ndërsa në opsionin e dytë votën e tyre e përcakton besimi në lider të partisë. Vetëm në opsionin e tretë ato janë deklaruar se votojnë në bazë të programit partiak.

Të pyetur se cilat janë arsytet që kanë ndikuar më së shumti në përcaktimin e votës së tyre, 24.3 për qind e grave të anketuara pohojnë se arsyeja kryesore është “Fushata zgjedhore e partisë”. Me 13.5 për qind thonë se modaliteti “Zhgënjimi me partitë e tjera” është arsyeja që ka ndikuar në votën e tyre. Dy aspekte tjera që janë me rëndësi për votueset është “Kualiteti i kuadrove të partisë” 10.8 për qind, dhe “Lidhjet familjare me aktivistët e partisë” 7.1 për qind .

Në fund, vlen të ceket se arsyeja e përcaktimit të votës në zgjedhjen e dytë që ka marrë përqindjen më të lartë është: “Lideri i partisë”, me 12.3 për qind.

Cilat janë tri arsytet që kanë ndikuar më së shumti në përcaktimin e votës suaj?

Nr	Arsyet	Zgjedhja e parë	Zgjedhja e dytë	Zgjedhja e tretë
1	Fushata zgjedhore e partisë	24.3%	0%	0%
2	Lidhjet familjare me aktivistë të partisë	7.1%	0.8%	0%
3	Zhgënjimi me partitë e tjera	13.5%	3.5%	0%
4	Kualiteti i kuadrove të partisë	10.8%	10.4%	0.8%
5	Përfaqësimi më i mirë i interesave të grave	3%	8.8%	1.3%
6	Kontributi i dëshmuar i partisë deri më tani	2.6%	10.8%	7.0%
7	Lideri i partisë	2.9%	12.3%	9.0%
8	Puna e degës lokale të partisë	0%	4.4%	3.9%
9	Përkrahja ndërkombëtare e partisë	0%	1.5%	3.0%
10	Programi i partisë	0.8%	0.5%	25.6%
11	Diçka tjetër	0.5%	0.4%	1.1%
12	Ref/PP	34.6%	46.9%	48.4%

Si votojnë gratë në Kosovë?

Të kategorizuara sipas partive, votueset e Lëvizjes Vetëvendosje 32.1 për qind janë më së shumti të ndikuara nga lideri i partisë. Pasojnë votueset e AAK-së 18 për qind, ato të LDK-së 14.7 për qind, kurse më pak të ndikuara nga lideri i partisë janë votueset e PDK-së 11.3 për qind.

“Fushata zgjedhore e partisë” është arsyeja e parë më me rëndësi për votueset e PDK-së 28.9 për qind, LDK-së 37.3 për qind, ; Lëvizjes Vetëvendosje 37.9 për qind dhe AAK-së (54 për qind).

Arsyeja e radhës për nga rëndësia është “Kualiteti i kuadrove të partisë”: LDK (25.3 për qind), PDK 17.5 për qind, Lëvizja Vetëvendosje 17.2 për qind dhe AAK 10 për qind.

Arsyet për zgjedhjen e partisë


	PDK	LDK	VV	AAK
Fushata zgjedhore e partisë	28.9	37.3	37.9	54
Lidhjet familjare me aktivistë të partisë	15.5	12	5.2	8
Zhgënjimi me partitë tjera	7.2	13.3	31	18
Kualiteti i kuadrove të partisë	17.5	25.3	17.2	10
Përfaqësimi më i mirë i interesave të grave **	12.4	18.7	24.1	20
Kontributi i dëshmuar i partisë deri më tani	16.5	24	5.2	12
Lideri i partisë	11.3	14.7	32.8	18
Puna degës lokale të partisë	3.1	1.3	3.4	8
Përkrahja ndërkombëtare e partisë ***	4.1	4	1.7	2
Programi i partisë	37.1	49.3	41.4	26

Sa i përket ndikimit të familjes në votën e grave të anketuara, hulumtimi ynë ka gjetur se për shumicën e tyre familja nuk e vendos votën.

Bisedat në familje nuk kanë “Kurrfarë ndikimi” në votim për 40.1 për qind të respondentëve, dhe “Ndikim shumë të vogël” për 28.1 për qind.

Në anën tjetër, “Ndikim vendimtar” kanë për 10.1 për qind, ndërsa “Ndikim shumë të madh” për 13.8 për qind.


Për mendimin tuaj sa kanë pasur ndikim bisedat në familje se për kë do të votoni?



PARTICIPIMI POLITIK

Një numër mjaft i vogël i të anketuarave pohuan se janë anëtare të ndonjë partie politike – 93.3 për qind nuk janë të anëtarësuara në asnjë parti. Nga ato që janë anëtare partie, 1.8 për qind pohojnë të jenë në LDK, 2.4 për qind në PDK, 1.3 për qind në AAK, 0.3 për qind në AKR dhe 1.1 për qind në Lëvizjen Vetëvendosje.

Sa i përket anëtarësisë partiake të anëtarëve të familjes, anëtarësia e bashkëshortit në përgjithësi nuk ishte shumë më e lartë se e respondentes




Në pyetjen se “A e simpatizoni ndonjë parti?”, 29.9 për qind pohuan se simpatizojnë LDK-në, 28.2 për qind cekën PDK-në, 18.8 për qind Lëvizjen Vetëvendosje dhe 17.9 për qind AAK-në, kurse AKR-në 1 për qind.

LISTAT E MBYLLURA VS. LISTAT E HAPURA

Në Kosovë votohet me lista të hapura dhe kjo praktikë ka ngjallur debate publike lidhur me votimin me listat zgjedhore të hapura apo të mbyllura dhe pyetjes se cili opsion i konvenon më shumë demokracisë në vend, gjithmonë ka pasur dhe ka mendime të ndara lidhur me këtë. Por gratë në pyetjen tonë lidhur me këtë çështje dukshëm janë për votimin me lista të hapura. 64.9 për qind e të anketuarave preferojnë të votojnë me lista të hapura ndërsa 25.1 për qind preferojnë listat e mbyllura, ndërsa 8.7 për qind janë shprehur se nuk dinë, dhe 1.1 për qind nuk kanë përgjigje për këtë çështje.

Me cilën mënyrë preferoni të votoni?



KUOTA GJINORE

Aplikimi i kuotave gjinore në politikë si strategji apo mekanizëm për ngritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në politikë është duke u aplikuar në shumë vende të botës. Kjo ka sjellë ndryshime të shpejta kudo që ato aktualisht aplikohen dhe në të gjitha rastet ka ndikuar në rritje të përfaqësimit të përgjithshëm të grave në parlamente në botë.⁸

Të pyetura për qëndrimin e tyre se sa pajtohen me kuotat gjinore në politikë, gratë janë deklaruar se pajtohen fuqishëm me 19.5 për qind, pasuar me 48.6 për qind e të cilat pajtohen, ndërsa 13.4 për qind nuk pajtohen dhe vetëm 3.8 për qind fuqishëm nuk pajtohen.

Nga hulumtimi del se shumica e grave janë në favor të kuotave gjinore dhe se aplikimi i kuotës gjinore të sanksionuar në ligjin për zgjedhjet e korrigjon nën-përfaqësimin e grave në politikën kosovare. Sado që kuota gjinore gjer më tash ka “mbijetuar” reformat zgjedhore të dhe në pamje të parë duket se është arritur një konsensus shoqëror lidhur me to, siç po shihet edhe nga deklaratimet e të anketuarave, në adresë të kuotës ka zëra kritikë që vijnë jo vetëm nga politika dhe politikanët por edhe nga shtresat tjera shoqërore.

Kritika më e shpeshtë që i bëhet aplikimit të kuotës gjinore është mungesa e “legjitimitetit” të grave të zgjedhura përmes kuotës dhe “cilësisë” së përfaqësimit.

⁸ Women occupy a mere 18.5 percent of the seats in national parliaments around the world. “Mandated Spaces for Marginalized Faces: Gender Quotas in the Middle East” By Kristine H. Goulding

VOTIMI FAMILJAR

Ekzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në votuesit, si p.sh., mosha, gjinia, niveli i arsimimit, profesioni, statusi ekonomik, prejardhja etnike dhe religjioze, por edhe faktorët tjerë si familja dhe grupet tjera. Në disa hulumtime të kryera në Kosovë është adresuar çështja e votimit familjar që është cilësuar si fenomen i cili për pasojë ka shkëlqen e të drejtës së grave, vajzave dhe të moshuarve për votë të lirë.⁹

Bazuar në një definicion të ofruar nga Komisioni i Venedikut, “Votimi Familjar” paraqitet në rastet kur një anëtar i gjinisë mashkullore në familje, shoqëron një apo më shumë të afërm të gjinisë femërore në kabinën e votimit. Praktikrat e tillë janë arsyetuar me analfabetizimin e votuesve të gjinisë femërore dhe asistimin nga të afërmit e tyre gjatë votimit. Argumenti se shumica e anëtarëve të familjes votojnë njëjtë dhe se shumica janë analfabetë nuk tingëllon shumë bindshëm dhe duhet të kundërshtohet.¹⁰

Nga përgjigjet e grave dhe vajzave të anketuara për këtë hulumtim në pyetjen se “A votoni personalisht apo dikush nga familja juaj voton për ju”, vetëm 4,9 për qind e respondentëve kanë pranuar se dikush nga familja voton për ato, 8 për qind kanë refuzuar të përgjigjen, ndërsa në pyetjen “për mendimin tuaj sa kanë pasur ndikim bisedat në familje se për kë do të votoni”, 9,6 për qind kanë thënë se janë vendimtare për to se për kë do të votojnë, 16,8 për qind kanë pranuar se kanë ndikim të fuqishëm, 29,4 për qind kanë ndikim të dobët, ndërsa 38,7 për qind kanë thënë se nuk kanë fare ndikim në mënyrën se si votojnë.

Është evidente se ndikimi i familjes dhe bisedave në familje ndikojnë në përcaktimin e votës, por në të njëjtën kohë është po ashtu e nevojshme që gratë dhe vajzat e reja të vetëdijesohen se e drejta e votës është e pakontestueshme dhe se cenimi i saj përbën shkelje të të drejtave të tyre dhe sanksionohet me ligj.

⁹ Top problemet zgjedhore, (Qasje praktike për të kthyer besimin në procesin zgjedhor) Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, Forum 2015 (<http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/05/Top-Problem-et-Zgjedhore-ALB.pdf>).

¹⁰ Po Aty

REALIZIMI I HULUMTIMIT

Mostra

Në këtë hulumtim janë anketuar vetëm pjesëtarët e gjinisë femërore të cilat kanë të drejtë vote, pra nga moshë 18 vjeçare e më shumë.

Mostra e hulumtimit të QKSGj ka qenë 1050 gra dhe vajza, prej tyre janë anketuar 49,9 për qind në fshatra dhe 47, 3 për qind në qytete, ndërsa 2,6 për qind në qyteza. Prej tyre 66,6 për qind janë të martuara, të pamartuara janë 30,4 për qind, ndërsa të veja 2,7 për qind.

Nga 10 gra të anketuara, 427 gra (42.5 përqind) janë anketuar në fshat, 357 gra (35.5 përqind) në qytet, ndërsa 221 gra (22 përqind) në qyteza. Në hulumtim janë përfshirë të gjitha komunitat e Kosovës.

Instrumenti i hulumtimit

Hulumtimi është realizuar në bazë të pyetësorit i cili është hartuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Në hartimin e pyetësorit kanë marrë pjesë ekspertë lokalë dhe ndërkombëtarë, nga lëmia e sociologjisë, psikologjisë dhe studimeve gjinore. Biloqet tematike të pyetësorit përfshijnë këto çështje:

- TË DHËNAT FAMILJARE
- QËNDRIMET RRETH ROLIT TË FEMRËS NË FAMILJE DHE SHOQËRI
- QËNDRIMET RRETH ROLIT TË SHTETIT NË SHOQËRI
- INFORMIMI
- QËNDRIMET MBI ROLIN E FEMRËS NË POLITIKË
- SI VOTOJNË GRATË?

Hulumtimi në terren dhe përpunimi i të dhënave

Hulumtimi është realizuar nga ekipi i QKSGj, ndër të cilët kishe edhe disa vullnetarë. Ekipi përbëhej nga 20 anketuese. Si pjesë e mandatit të ngritjes së kapaciteteve, QKSGj ka angazhuar anketuese pa përvojë, të cilat i janë nënshtruar disa trajnimeve dhe mbikqyrjes së rregullt. Puna në terren ka zgjatur 20 ditë, mes qershorit dhe korrikut 2013.

Anketimi është kontrolluar nga 4 supervizorë, dhe është dëshmuar të jetë i kualitetit të lartë. Në përgjithësi, anketueset janë pritur mirë nga respondentet, sidomos në zonat rurale.

Përpunimi i të dhënave është bërë në programin SPSS 14.0 dhe prezantimi i rezultateve bëhet në formë të tabelave sintetike (që përmbajnë Frekuencat, Përqindjet).

Ekipi

Hulumtimi “Si votojnë gratë në Kosovë?” është realizuar me iniciativën të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore. Hulumtimi është mundësuar nga mjetet e Kvinna Till Kvinna (KTK). Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë:

Udhëheqja e projektit, analiza e të dhënave dhe përpilimi i pyetësorit: Luljeta Vuniqi.

Përpilimi i pyetësorit, trajnimi dhe shtrirja në terren: Sibel Halimi

Futja e të dhënave dhe paraqitja në formë tabelare: Donjeta Demolli

Ekipi i Anketuesve:: Afërdita, Armend, Dhurata, Fexhrie, Hana, Ilir, Kenan, Kushtrim, Lumturie, Marigona, Muhamet, Nadire.

Qendra Kosovare e Studime Gjinore (QKSGJ) është një organizatë joqeveritare, e cila ka për mandat strategjik që të përfshijë perspektivën gjinore në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare duke zhvilluar studime e politika gjinore të cilat janë të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore.

Qëllimi i Qendrës është që të shërbejë si katalizatorë për ndryshime në hulumtimet, analizat e politikave dhe shpërndarjen e informacioneve në shoqërinë kosovare dhe që nëpërmjet të aktiviteteve të veta të informojë organizatat joqeveritare e qeveritare, studentët e mësimdhënësit e universiteteve, gazetarët, hartuesit e politikave e të tjera.

316.47/.48-053.81(496.51)(047)

Si Votojnë Gratë në Kosovë

/ [Autore Luljeta Vuniqi]. – Prishtinë:

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2014. - 41 f. ; 21 cm.

Përmbledhja : f. 2-5.

1.Vuniqi, Luljeta

ISBN 978-9951-568-13-4

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)

Telefoni: (381) 38 735 991

Email: info@kgscenter.net

Adresa: Nëna Terezë

Prishtinë, Kosovë

www.kgscenter.net

Si votojně gratě ně Kosově?